

## *Kapitulli III i Pestë*

# *Aktivitetet e tjera të Bankës së Shqipërisë*

### **5.1. SISTEMI I PAGESAVE.**

Objektivat strategjikë për zhvillimin e sistemit të pagesave në Shqipëri.

Objektivi strategjik i Bankës së Shqipërisë është rritja e qarkullimit të parave nëpërmjet sistemit bankar dhe për pasojë reduktimi i sasisë së *cash*-it në ekonomi.

Banka e Shqipërisë do të punojë në dy drejtime: nga njëra anë, për përmirësimin e sistemit të pagesave ndërbankare dhe, nga ana tjetër, për përmirësimin e sistemit të pagesave me vlera të vogla.

Realizimi i këtyre objektivave strategjikë do të arrihet nëpërmjet:

- \* Implementimit të një sistemi të tipit RTGS për trajtimin e gjithë pagesave në vlera të mëdha deri në fund të vitit 2001.
- \* Automatizimit të sistemit ekzistues të kleringut të urdhërpagesave dhe çeqeve si dhe krijimit të qendrave të reja të kleringut.
- \* Standardizimit të instrumenteve të pagesës, duke u përqendruar fillimisht në standardizimin e instrumenteve ekzistuese të pagesave (urdhërpagesa, çeqe) dhe duke synuar aplikimin maksimal të standardeve ekzistuese ndërkombëtare.
- \* Rritjes së nivelit të informimit dhe të transparencës me publikun duke shtuar numrin e publikimeve në lidhje me sistemin e pagesave dhe elementet përbërëse të tij.
- \* Përmirësimin të kuadrit ligjor e rregullator për sistemin e pagesave.

#### **5.1.1 Informacion i përgjithshëm.**

***Viti 1999 nuk shënoi ndonjë përmirësim cilësor të sistemit shqiptar të pagesave.*** Në përgjithësi, sistemi i pagesave në Shqipëri vazhdon të ketë të njëjtat probleme si edhe vite më parë si: nivel i lartë i qarkullimit të *cash*-it, vonesa në transferimin e parave sidomos brenda vendit, diferenca të mëdha në teknologji si dhe në shtrirjen e rrjetit në sistemin bankar shqiptar etj..

Megjithatë, gjatë vitit 1999, zhvillimet në sektorin bankar e financiar si shtimi i numrit të bankave, konsolidimi i aktivitetit të atyre ekzistuese, çelja e degëve jashtë qytetit të Tiranës nga ana e disa bankave private etj., sollën rritje të volumit të transaksioneve të kryera nëpërmjet sistemit të pagesave dhe forcuan nevojën për një administrim më të kujdesshëm të likuiditetit dhe të riskut nga ana e bankave. Në këtë kuadër, gjatë vitit 1999 Banka e Shqipërisë realizoi unifikimin e llogarisë rrjedhëse me atë të rezervës së detyrueshme të bankave të nivelit të dytë, duke ndikuar mjaft në cilësinë e administrimit ditor të likuiditetit nga ana e bankave si dhe në reduktimin e riskut të sistemit të pagesave.

Nga ana tjetër, viti 1999 ishte mjaft i rëndësishëm në lidhje me ndërmarrjen e disa hapave që do të ndikojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit ndërbankar të pagesave në Shqipëri. Banka e Shqipërisë mori vendimin për implementimin pranë saj të një sistemi të tipit *Real Time Gross Settlement* – RTGS, me qëllim minimizimin dhe monitorimin e riskut në sistemin e pagesave, përmirësimin e infrastrukturës komunikuese ndërbankare, mbështetjen e zhvillimeve të mëtejshme të sistemit të pagesave si dhe zvogëlimin e përdorimit të *cash*-it për kryerjen e pagesave.

Në zbatim të këtij vendimi, gjatë vitit 1999 u përgatit edhe dokumenti “Kërkesat e biznesit të sistemit RTGS”<sup>24</sup>, i cili përmban të detajuara të gjitha kërkesat që Banka e Shqipërisë ka ndaj një sistemi të tillë, si teknike ashtu edhe funksionale.

Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 1999, futi në përdorim SWIFT-in për kryerjen e kleringut të urdhërpagesave të klientëve.

Së fundi, Komiteti Kombëtar i Pagesave u angazhua kryesisht në procesin e harmonizimit dhe të koordinimit ndërbankar në drejtim të sistemit të pagesave. Në kuadrin e këtij komiteti filloi puna për standardizimin e urdhërpagesës dhe të çekut, për standardizimin e marrëveshjeve mbi përdorimin e debitimit direkt dhe “*standing order*” si dhe për unifikimin e afateve të kryerjes së pagesave në lekë me urdhërpagesë dhe çek.

### 5.1.2 Instrumentet e pagesës.

Instrumentet e pagesës më të përdorura, gjatë vitit 1999 vazhduan të jenë urdhërpagesa dhe çeku bankar. Përdorimi i tyre shënoi rritje në krahasim me një vit më parë. Kështu, volumi i pagesave të kaluara në seancat e kleringut gjatë vitit 1999 ishte rreth 50 miliardë lekë (rreth 357 milionë dollarë amerikanë), vlerë e cila përfaqëson rreth 7.2 për qind të vlerës totale të qarkulluar në llogaritë e bankave. Volumi i aktivitetit të kleringut për vitin 1999 shënon një rritje prej rreth 35 për qind në krahasim me atë të vitit 1998.

---

<sup>24</sup> “Kërkesat e biznesit” ose “Kërkesat e përdoruesit” është një dokument i cili përshkruan sistemin që duhet të ndërtohet nga pikëpamja e përdoruesit të tij, me qëllim që të realizohen të gjitha përmirësimet e marra përsipër.

Rritjen më të madhe e kanë patur pagesat nëpërmjet çeqeve bankare, vlera e të cilave këtë vit ka qenë 24,5 miliardë lekë (175 milionë dollarë amerikanë) dhe përfaqëson një rritje prej 57 për qind me vlerën e vitit 1998. Volumi i pagesave në numër dhe në vlerë ishte përkatësisht 21 për qind dhe 32,6 për qind më i lartë se në vitin 1998. Kontributin më të madh në këtë rritje e ka dhënë përdorimi i çeqeve bankare, sidomos për të paguar taksat doganore dhe për të shlyer një sërë detyrimesh të tjera. Kjo i ka ndihmuar bizneset të heqin dorë gjithnjë e më shumë nga përdorimi i *cash*-it për qëllime të tilla. Ndërkohë që edhe urdhërpagesat kanë shënuar një rritje prej 15,7 për qind ndaj vitit 1998, me një vlerë totale prej 25,6 miliardë lekësh (ose 185 milionë dollarë amerikanë). Vlera mesatare ditore e instrumenteve të pagesës të kaluar në seancat e kleringut është rreth 199 milionë lekë (ose 1,2 milionë dollarë amerikanë) nga të cilët rreth 100 milionë i takojnë urdhërpagesave dhe pjesa tjetër çeqeve bankare. Numri i urdhërpagesave të kaluara në klering ka shënuar, gjithashtu, rritje në krahasim me vitin 1998, duke vajtur në 53.357 (nga 43.183 në vitin 1998). Gjithashtu, është rritur edhe numri i çeqeve duke vajtur në rreth 7.000 (nga 4.800 për vitin 1998).

Më tej, gjatë vitit 1999 nga disa banka private të nivelit të dytë janë futur në përdorim instrumente të reja pagesash si ATM, është emetuar karta DINERS CLUB dhe VISA etj.. Niveli i përdorimit të këtyre instrumenteve është ende i ulët. Megjithatë, është mjaft i rëndësishëm fakti që bankat e nivelit të dytë në Shqipëri po i kushtojnë rëndësi përmirësimit të infrastrukturës së tyre të brendshme me qëllim mbështetjen e përdorimit të instrumenteve të pagesës *jo-cash* nga ana e klientëve shqiptarë. Kjo flet për një përmirësim të teknologjisë bankare në Shqipëri, që mendohet se do të përmirësojë kulturën e marrëdhënieve të popullsisë me bankat dhe do të ndikojë, në afat të gjatë, në zhvillimin e sistemit të pagesave në Shqipëri.

Gjithësesi, në ekonominë shqiptare vazhdon të mbizotërojë *cash*-i si mjete kryesor dhe më i besueshëm për kryerjen e pagesave brenda vendit.

**Tabela 13: Volumi i transaksioneve të kaluara në seancat e kleringut për vitin 1999(mijë lekë).**

| Instrumenti   | Volumi        |               | Vlera                |                      |
|---------------|---------------|---------------|----------------------|----------------------|
|               | 1998          | 1999          | 1988                 | 1999                 |
| Urdhërshirim  | 43.183        | 53.357        | 22,161,675.00        | 25,642,048.00        |
| Çek bankar    | 4.837         | 6.000         | 15,538,479.00        | 24,372,365.00        |
| <b>Totali</b> | <b>48.020</b> | <b>59.357</b> | <b>37,700,154.00</b> | <b>50,014,413.00</b> |

Burimi: Banka e Shqipërisë

**Tabela 14: Vlera mesatare e instrumenteve të pagesës(lekë).**

| Instrumenti  | Vlera mesatare për instrument |              | Vlera mesatare mujore   |                         |
|--------------|-------------------------------|--------------|-------------------------|-------------------------|
|              | Viti 1988                     | Viti 1999    | Viti 1988               | Viti 1999               |
| Urdhërshirim | 513,204.00                    | 480,575.15   | 1,846,806,226.00        | 2,136,837,333.33        |
| Çek bankar   | 3,212,421.00                  | 4,062,061.00 | 1,294,873,247.00        | 2,031,030,416.67        |
|              |                               |              | <b>3,141,679,474.00</b> | <b>4,167,867,750.00</b> |

## 5.2. EMISIONI I MONEDHËS

Emisioni i monedhës në afatin e mesëm.

Banka e Shqipërisë synon të përmirësojë strukturën e monedhës në qarkullim në favor të prerjeve të mëdha prej 500 dhe 1000 lekë. Nisur nga nevoja për zëvendësimin e kartëmonedhave të dëmtuara dhe të atyre që hiqen nga qarkullimi do të shtypet kartëmonedhë rreth 50 milionë copë dhe me kosto 2.5 milionë dollarë amerikanë

Gjatë vitit 1999, janë emetuar gjithësej, në sektorin metalik të Shtypshkronjës së Bankës së Shqipërisë, 710.000 copë monedha të prerjes 5 lekë dhe 974.893 copëmonedha të prerjes 1 lek, që në vlerë japin shumën 4.524.893 lekë. **Emisioni është 85 miliardë lekë, ndërsa emetimi gjithësej 174.6 miliardë lekë.**

**Monedha në qarkullim është rritur në krahasim me një vit më parë.** Shuma e monedhës në qarkullim është 82.908.074.567,25 lekë ose 13.538.630.592.30 lekë më shumë. Si faktorë kryesorë në rritjen e monedhës në qarkullim mund të përmendim:

- ✍ Shtimin e popullsisë shqiptare me rreth 15 për qind (si pasojë e ardhjes së të shpërngulurve nga Kosova) gjë që rriti nevojat për përdorimin e monedhës fizike.
- ✍ Kryerjen e shpenzimeve të konsiderueshme buxhetore gjatë muajit dhjetor të vitit 1999. Ky fenomen i grumbulloi shpenzimet në një muaj të caktuar duke mos respektuar ritmikën e kryerjes së tyre sipas buxhetit të miratuar. Rezultat i këtij veprimi ishte shtimi i monedhës në qarkullim me 6 miliardë lekë, që përfaqëson 44 për qind të shtesës vjetore të monedhës në qarkullim.

Po kështu, gjatë vitit 1999 është rritur më shumë kartëmonedha e asgjësuar. Gjithësej, janë asgjësuar 27.648.975 copë kartëmonedha me vlerë 6.328.330.450 lekë nga 4.251.561.600 lekë që ishte vlera e monedhës së asgjësuar një vit më parë. Përqindjen më të lartë në dëmtim vazhdon ta ruajë kartëmonedha 100 lekë.

Përsa i përket falsifikimit të monedhës vërehet se në vitin 1999, krahasuar me vitin 1998, është më i lartë si numri i kartëmonedhave të falsifikuara të kapura ashtu edhe vlera e tyre. Ashtu si në vitin 1998, numri më i madh i rasteve të falsifikimit vërehet për kartëmonedhën e prerjes 500 lekë të emetuar në vitin 1994. Por, gjatë vitit 1999 ka patur raste të falsifikimit edhe të prerjes 1000 lekë, emisioni i ri i vitit 1996. Nga ekzaminimet e bëra këto kartëmonedha të falsifikuara janë lehtësisht të dallueshme nga përdoruesit.

**Tabela 15: Numri i kartëmonedhave të falsifikuara (copë).**

| Prerjet   | Viti 1999 | Viti 1998 | Progresive nga viti 1992 |
|-----------|-----------|-----------|--------------------------|
| 1000 lekë | 579       | 103       | 9987                     |
| 500 lekë  | 681       | 521       | 3202                     |
| 200 lekë  | 125       | 1         | 182                      |

Tabela 16: Struktura e monedhës në qarkullim në fund të viteve 1998 dhe 1999. *Mijë copë/lekë*

| Prerjet            | Viti 1998      |               |                   |               | Viti 1999      |               |                   |               |
|--------------------|----------------|---------------|-------------------|---------------|----------------|---------------|-------------------|---------------|
|                    | Mijë copë      | %             | Mijë lekë         | %             | Mijë copë      | %             | Mijë lekë         | %             |
| <b>K/m</b> 5000    |                |               |                   |               | 476            | 0.25          | 2,380,080         | 2.90          |
| 1000               | 37,219         | 22.24         | 37,219,387        | 54.14         | 40,298         | 21.00         | 40,298,040        | 49.04         |
| 500                | 51,152         | 30.57         | 25,576,070        | 37.20         | 64,048         | 33.37         | 32,023,948        | 38.97         |
| 200                | 21,667         | 12.95         | 4,333,518         | 6.30          | 27,706         | 14.44         | 5,541,295         | 6.74          |
| 100                | 14,223         | 8.50          | 1,422,334         | 2.07          | 17,831         | 9.29          | 1,783,140         | 2.17          |
| 50                 | 769            | 0.46          | 38,472            | 0.06          |                |               |                   |               |
| 10                 | 8,106          | 4.84          | 81,064            | 0.12          | 7,684          | 4.00          | 76,845            | 0.09          |
| 5                  | 6,523          | 3.90          | 32,615            | 0.05          | 6,373          | 3.32          | 31,863            | 0.04          |
| 3                  | 6,513          | 3.89          | 19,540            | 0.03          | 6,489          | 3.38          | 19,466            | 0.02          |
| 1                  | 21,172         | 12.65         | 21,172            | 0.03          | 21,016         | 10.95         | 21,016            | 0.03          |
| <b>Total k/m</b>   | <b>167,344</b> | <b>100.00</b> | <b>68,744,172</b> | <b>100.00</b> | <b>191,921</b> | <b>100.00</b> | <b>82,175,693</b> | <b>100.00</b> |
| <b>M/m</b> 50      | 6,786          | 7.31          | 339,310           | 54.27         | 7,238          | 7.23          | 361,911           | 49.42         |
| 20                 | 7,811          | 8.41          | 156,216           | 24.98         | 10,117         | 10.11         | 202,349           | 27.63         |
| 10                 | 7,823          | 8.42          | 78,227            | 12.51         | 10,835         | 10.82         | 108,349           | 14.79         |
| 5                  | 6,037          | 6.50          | 30,184            | 4.83          | 7,686          | 7.68          | 38,429            | 5.25          |
| 2                  | 262            | 0.28          | 525               | 0.08          | 262            | 0.26          | 524               | 0.07          |
| 1                  | 10,230         | 11.02         | 10,230            | 1.64          | 10,279         | 10.27         | 10,279            | 1.40          |
| 0.5                | 8,754          | 9.43          | 4,377             | 0.70          | 8,721          | 8.71          | 4,361             | 0.60          |
| 0.2                | 18,902         | 20.36         | 3,780             | 0.60          | 18,862         | 18.84         | 3,772             | 0.52          |
| 0.1                | 22,093         | 23.79         | 2,209             | 0.35          | 22,033         | 22.01         | 2,203             | 0.30          |
| 0.05               | 4,161          | 4.48          | 208               | 0.03          | 4,082          | 4.08          | 204               | 0.03          |
| <b>Total m/m</b>   | <b>92,859</b>  | <b>100.00</b> | <b>625,266</b>    | <b>100.00</b> | <b>100,115</b> | <b>100.00</b> | <b>732,381</b>    | <b>100.00</b> |
| <b>T o t a l i</b> | <b>260,203</b> |               | <b>69,369,438</b> |               | <b>292,036</b> |               | <b>82,908,074</b> |               |

Ndryshimet mujore (pakësimi ose shtesa) e monedhës në qarkullim gjatë vitit, të shprehura në miliardë lekë janë vërtetuar si më poshtë:

|             |             |             |             |
|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Janar -1.5  | Prill 3.5   | Korrik 0.4  | Tetor 0.3   |
| Shkurt -1.5 | Maj 2.3     | Gusht 1.4   | Nëntor -0.1 |
| Mars 0.8    | Qershor 1.7 | Shtator 0.1 | Dhjetor 6   |

### 5.3. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Kriza e Kosovës kërkoi një shtim të përshpejtuar kontaktesh dhe rritje të ndjeshme të bashkëpunimit, në veçanti me FMN, për rishikimin e treguesve makroekonomikë, për deficitin buxhetor, për programin e emergjencës pas konfliktit, për PRGF-në etj.. Ndërsa projektet me BB u realizuan sipas kalendarit të përcaktuar.

Bashkëpunimi dypalësh dhe shumëpalësh me bankat qendrore është intensifikuar ndjeshëm. Ai është konkretizuar në firmosjen e Marrëveshjes së Bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes bankare me Bankën Qendrore të Greqisë në fillim të vitit, në kuadrin e Protokollit të Guvernatorëve të Bankave Qendrore të Rajonit. Hapa për marrëveshje të ngjashme janë bërë edhe me bankat qendrore të Turqisë dhe të Bullgarisë.

Në drejtim të shkëmbimit të përvojës në fushën e legjislacionit, operacioneve monetare, sistemit të pagesave etj., janë shtuar marrëdhëniet me bankat qendrore të vendeve të tjera të rajonit si Sllovenia, Kroacia, Rumania etj.. Marrëdhënie të mira teknike janë shënuar me korrespondentët tashmë disavjeçarë si Rezerva Federale e Nju Jorkut, BIS Baseli si edhe me Bankën Qendrore të Austrisë, Francës, Anglisë, Polonisë, Turqisë, Gjermanisë në fushën e asistencës teknike.

Në zbatim të politikës së integritit europian gjatë këtij viti u vendosën marrëdhëniet e para me Bankën Qendrore Europiane.